

UDHËZIM
Nr. 13, datë 17.3.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 20, DATË 18.7.2024,
PËR RREGULLAT MBI MASAT E VEÇANTA TË KONTROLLIT PËR
ÇRRËNJOSJEN DHE PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË KANCERIT TË
PATATES “*SYNCHYTRIUM ENDOBIOTICUM*” (SCHILBERSKY) PERCIVAL¹**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe mbështetur në pikën 3, të nenit 8, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 20, datë 18.7.2024, bëhen këto ndryshime:

1. Aneksi II, zëvendësohet me aneksin bashkëlidhur këtij udhëzimi;

2. Pika 1.1 e aneksit IV, zëvendësohet me formulimin si vijon:

“1.1. Pas një minimumi prej 50 vitesh nga zbulimi i fundit i dëmtuesit të specifikuar, nëse ka një të dhënë pa shprehje të kulturave në zonën e infektuar, që tregon se dispozitat e pikave 2 dhe 3, të nenit 6, janë respektuar gjatë të gjithë kohës dhe se zona e infektuar nuk është përdorur si kullotë e përhershme.

Kur zona e infektuar është përdorur si kullotë e përhershme, masat mund të revokohen vetëm kur nuk janë zbuluar shenja infektimi nga dëmtuesi i specifikuar në mostrat e tokës, të cilat janë marrë duke aplikuar skemën që do të përdoret për të marrë dheun për testimin e përcaktuar në pikën 1.2 të këtij aneksi; ose”.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

¹Ky udhëzim përaftron plotësisht Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2024/2382, e datës 9 shtator 2024, duke ndryshuar Rregulloren Zbatuese (BE) 2022/1195, në lidhje me formatin për studimet e “*Synchytrium endobioticum*” (Schilbersky) Percival, përcaktimin e vendeve të infektuara të prodhimit dhe revokimin e masave në zonat e infektuara.

FORMATI I VROJTIMIT SIÇ PËRMENDET NË NENIN 3

Formati për paraqitjen e rezultateve të vrojtimit të dëmtuesit të kancerit të patates, të kryera gjatë vitit kalendarik që i paraprin vitit të raportimit.

Kjo tabelë përdoret vetëm për rezultatet e vrojtimit për patatet e vjelura

Rajoni ose zona	Kategoria	Zona e mbjelljes (ha)	Inspektimi vizual i zhardhokëve		Testimi laboratorik		Madhësia fillestare e zonës së infektuar ⁽¹⁾ (ha)	Madhësia e përditësuar e zonës së infektuar ⁽²⁾ (ha)	Numrat e njoftimit të shpërthimeve të reja të njoftuara, sipas rastit, në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar	Informacion tjetër
			Numri i loteve	Numri i loteve të dyshimta	Numri i mostrave të testuara	Numri i mostrave pozitive				
	Zhardhokët e patates për mbjellje									
	Zhardhokët e patates përveç për mbjellje									

⁽¹⁾ Madhësia totale e zonës së infektuar para vitit të mbuluar nga raporti.

⁽²⁾ Madhësia totale e zonës së infektuar në vitin e mbuluar nga raporti.